



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikolas Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 14 shkurt 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër drejtuar Administratores për Dorëzim Informacioni mbi Regjimin e
Paraburgimit dhe për Parashtrime lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të
Pjetër Shalës**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të Akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 39(1) dhe (13) dhe 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë Urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas një vendimi të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, pas vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjikë”).⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i redaktuar konfidencial dhe një version i redaktuar publik dolën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej publik i Aktakuzës së Konfirmuar u paraqitën më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mocionin e Mbrojtjes për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidenciale, dhe më 16 nëntor 2021, F00107/A01, publike.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial (një version i redaktuar publik u lëshua më 6 maj 2021, F00008/RED); F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar publik u lëshua më 15 prill 2021, F00008/A01/RED).

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi një kërkesë për lirim të përkohshëm të paraqitur nga Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja").⁷ Gjykata e Apelit e la në fuqi këtë vendim më 20 gusht 2021.⁸
5. Më 10 shtator 2021,⁹ 10 nëntor 2021 ("Vendimi i Tretë për Paraburgimin"),¹⁰ dhe 28 janar 2022 ("Vendimi i Katërt për Paraburgimin"),¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikoi paraburgimin e z. Shala dhe urdhëroi vazhdimin e tij.
6. Më 11 shkurt 2022, Gjykata e Apelit nxori vendim mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit të Tretë për Paraburgim ("Vendimi i Gjykatës së Apelit").¹² Ndër të tjera, ajo ia ktheu Vendimin e Tretë për Paraburgim Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm, me qëllim që të kërkonte parashtrime të tjera nga Administratorja lidhur me regjimin e paraburgimit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe të ftonte Mbrojtjen të verifikonte nëse Belgjika ishte e

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. Një version i redaktuar publik u lëshua më 26 prill 2021, F00019/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u lëshua më 23 qershor 2021, F00045/RED.

⁸ KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 20 gusht 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, IA001/F00005/RED.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00075, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 shtator 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F00075/RED.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00105, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 nëntor 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F00105/RED.

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00133, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 28 janar 2022, konfidencial. Një version i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F00133/RED.

¹² KSC-BC-2020-04, IA003/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 11 shkurt 2022, konfidencial. Një version i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, IA003/F00005/RED.

gatshme dhe e aftë të zbatonte kushtet e propozuara nga z. Shala apo ndonjë kusht shtesë.¹³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Sipas nenit 39(1) dhe (13) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë, ndër të tjera, të lëshojë çdo urdhër apo vendim të nevojshëm për të siguruar që çështja të përgatitet si duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

8. Neni 41(10) i Ligjit parashikon se, deri kur aktgjykim të marrë formë të prerë, apo deri në lirimin e të paraburgosurit, pas përfundimit të dy (2) muajve që nga vendimi i fundit për paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake apo Trupi Gjykses i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse vazhdojnë të ekzistojnë ende arsytet për paraburgim dhe jep një vendim për zgjatjen ose përfundimin e paraburgimit. Kjo rrjedh gjithashtu edhe nga rregulla 57(2) e Rregullores.

III. DISKUTIM

9. Duke marrë parasysh se Gjykata e Apelit e udhëzoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake të kërkonte parashtrime të mëtejshme nga Administratorja për regjimin e paraburgimit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pa cenuar asnjë vendim që mund të merret në lidhje me vendimin e dërguar tek ai për rishikim nga Gjykata e Apelit, urdhëron Administratoren të japë informacionin e detajuar në shtojcën e këtij urdhri, jo më vonë se të martën, 22 shkurt 2022.¹⁴

10. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në pajtim me Vendimin e Gjykatës së Apelit, fton Mbrojtjen të verifikojë nëse Belgjika është e gatshme dhe e aftë të zbatojë

¹³ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 54, 56-57, 60, 61.

¹⁴ Administratorja paraqet njëkohësisht, nëse është e nevojshme, një version të redaktuar publik të informacionit të kërkuar apo informon se ai nuk mund të nxirret.

kushtet e lirimit që ajo ka propozuar dhe/ose çdo kusht tjetër shtesë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu e quan të nevojshme të ndryshojë kalendarin e parashtrimeve për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala, sikundër përcaktohet në Vendimin e Katërt për Paraburgimin,¹⁵ me qëllim që të miratojë në kohë një vendim lidhur me Vendimin e Tretë për Paraburgimin, për pjesën e kthyer për rishikim nga Gjykata e Apelit, së bashku me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala. Rrjedhimisht, Mbrojtja duhet t'i paraqesë parashtrimet e saj për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se të mërkurën, 2 mars 2022 dhe, në këto parashtrime, ajo duhet të trajtojë çdo përgjigje të marrë nga Belgjika dhe parashtrimet e Zyrës Administrative. Përgjigja e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe kundërpërgjigja e Mbrojtjes duhen dorëzuar në përputhje me afatin e përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores.¹⁶

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **URDHËRON** Administratoren të dorëzojë parashtrimet e detajuara në shtojcën e këtij Urdhri jo më vonë se të **martën, 22 shkurt 2022**; dhe
- (b) **URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë parashtrimet e veta për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala deri jo më vonë se të **mërkurën, 2 mars 2022** dhe në të njëjtat parashtrime, të trajtojë çdo përgjigje të marrë nga Belgjika dhe parashtrimet e lartpërmendura që do të dorëzohen nga Zyra Administrative, me

¹⁵ Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 50(b) dhe (c).

¹⁶ Palët paraqesin, nëse është e nevojshme, një version të redaktuar publik të parashtrimeve, përgjigjes dhe/ose kundërpërgjigjes, sipas rastit përkatës.

përgjigjet dhe kundërpërgjigjet, sipas afatit të përcaktuar në rregullën 76 të Rregullores.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikolas Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 14 shkurt 2022

Në Hagë, Holandë.